



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2020

*Departamenti i Mjekësisë Sociale
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK*

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2020

*Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK
Prishtinë 2020*

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2020” përfshinë të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Të dhënat të cilat i shfrytëzojmë për përgatitjen e Raportit të Gjendjes Perinatale nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës për vitin 2020 janë të mangëta, si për Statistikat e Lindjeve dhe Statistikat e vdekjeve, andaj kemi prezentuar lindjet sipas të dhënave nga Departamenti i SISH-it-IKSHPK, dhe të dhënat në dispozicion nga ASK.

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2020. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private.

Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes.

Foshnjët e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, rradhës së lindjes, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës.

Koeficienti i vdekshmërisë infantile është prezantuar sipas komunave, kurse koeficienti perinatale në mungesë të dhënave është prezentuar vetëm sipas vitit.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave

Duke pasë parasysh këto mangësi në burime relevante të të dhënave lexuesit dhe ata të cilët do të përdorin këtë hulumtim këshillohen që të marrin me rezervë vlerat e fituara të indikatorëve sepse nuk ilustrojnë në mënyrë të denjë realitetin e gjendjes perinatale në Kosovë

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domodoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD. C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMBLEDHJE	7
DEFINICIONET	8
METODOLOGJIA	10
TË DHËNAT KRYESORE	12
LINDJET.....	12
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	19
VDEKSHMËRIA FETALE.....	23
VDEKSHMËRIA PERINATALE	21
PËRFUNDIMET	26
REKOMANDIMET	28
BIBLIOGRAFIA	29
ANEX	30

PËRMBLEDHJE

Në vitin 2020, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 21,907 foshnje të lindur gjallë, prej tyre 479 jashtë Kosovës. Krahësuar me vitin paraprak (21,798) dallimi i të lindurve gjallë është 109 të lindur gjallë më shumë në vitin 2020.

Sipas SISH-IKSHPK në vitin 2020 janë raportuar gjithsej: 20,781 lindje(Lehona), foshnje të lindura 21,123 , të lindur gjallë 20,988 dhe 135 të lindur vdekur.

Në institucionet shëndetësore në vitin 2020 nga gjithsej lindje, 21% të lindjeve janë kryer me prerje cezariene.

Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj është e paraparë edhe në objektivën e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport i dedikohet vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë me qëllim identifikimit të situatës monitorimit të vazhdueshëm si dhe planifikimit të masave specifike adekuate në adresimin e problemeve rreth shëndetit perinatal.

DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit.

Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK dhe UNICEF-i.

I lindur nënkupton shkëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

I lindur gjallë nënkupton shkëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptcionit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

I lindur vdekur: Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptcionit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes.

Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale (≥ 500 g ose ≥ 22 javë).

Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ($\geq 1,000$ g ose ≥ 28 javë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal) definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

Vdekjet neonatale (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

vdekjet e hershme neonatale, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës dhe

vdekjet e vonshme neonatale që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë maternale paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përjashtuar shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

Vdekje e vonshme maternale është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

Metodologjia

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2020 nga ASK-së për statistikat vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga IKSHPK.

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjegjësisht Departamenti i Sistemit të Informimit grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bënë raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante, ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë bënë analizën e indikatorëve të disagreguar.

- ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”
- Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante dhe kalkulimin e indikatorëve të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e ka realizuar IKSHPK, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë.

Sfidat për grumbullimin e të dhënave:

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sfida është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK).
- Gjatë vitit 2019/2020 është punuar në unifikimin e formularit për raportim, megjithatë të dhënat nga ASK për vitin 2020 për lindje dhe vdekje nuk janë të kompletuara edhe pasë publikimit të fundit, prandaj në raportin e gjendjes Perinatale për vitin 2020, në mungesë të dhënave disa indikator të agreguar kanë diskrepancë krahasuar me vitet paraprake si dhe disa indikatorë tjerë nuk kemi pasë mundësi ti kalkulojmë.
- Përkundër ekzistimit të qarkores në fuqi për raportim të vdekjeve maternale, asnjë vdekje maternale nuk është raportuar nga institucionet shëndetësore gjatë vitit 2020, prandaj edhe nuk ka reflektim të këtij indikatorit në Raportin Perinatal 2020.
- Përfshirja në raportim e të gjitha komunave të Kosovës.
- Mungesa e analizimit të Shkaqeve të vdekjeve për vitin 2020 në nivel nacional gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.
- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve tjerë jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm brenda kujdesit shëndetësor.
- Në Raportin Perinatal për vitin 2020 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazikë dhe vazhdon të mbetet sfida për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit European EURO-PERISTAT.

TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2020 në Kosovë, të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private në departamentin e SISH -IKSHPK janë:

- 20,781, lindje(lehona)
- 21,123 foshnje të lindura
- 20,988 të porsalindur gjallë
- 135 të lindur vdekur
- raporti gjinor në lindje është 1,070 meshkuj në 1,000 femra
- shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 21 %

Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2020

#	Modalitetet	2020
1	Numri i lindjeve	20,781
2	Numri i të posalindurve të lindur të gjallë	20,988
3	Numri i vdekjeve fetale	135
4	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	6.4
5	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	43
6	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	1.9
7	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	8.0
8	*Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (‰)	21

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020

LINDJET

Në vitin 2020, sipas të dhënave të ASK-së, janë raportuar gjithsej 21,907 të lindur gjallë, prej tyre 479 të lindur jashtë Kosovës.

Sipas IKSHPK-së janë raportuar gjithsej 20,781 lindje (lehona), 20,988 të lindur gjallë dhe 135 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq. Diferenca e numrit të lindurve gjallë të raportuar nga ASK dhe IKSHPK për vitin 2020 është 919 të lindur gjallë.(Tab.2)

Tab.2. Raportimi i të dhënave nga dy burime të të dhënave

Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)	Foshnje të lindur gjallë	Të lindur vdekur
IKSHPK	21,123	20,988	135
ASK	-	21,907	-
Diferenca		919	

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020
ASK-Statistikat e Lindjeve 2020

Bazuar në raportin e IKSHPK-së: “Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor janë si në vijim: Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 11,272 apo 54.2%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 8,786 lindje apo 42.3%, në maternitete 209 lindje apo 1.3%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 514 raste ose 2.5% (Tab.3).

Tab.3. Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë-2020


Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Gjithsej foshnje të lindura gjallë	
	N	%	N	%	N	%
QKUK	8,786	42.3	9,016	42.7	8,917	42.5
Spitali	11,272	54.2	11,359	53.8	11,329	54.0
Materniteti jashtëspitalor	209	1.0	278	1.3	277	1.3
Institucione Publike	20,267	97.5	20,584	97.4	20,453	97.5
Institucione Private	514	2.5	539	2.6	535	2.5
Gjithsej	20,781	100.0	21,123	100.0	20,988	100.0

Burimi: IKSHPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2020 kishte gjithsej 20,781 lindje, prej tyre 21,907 të lindur të gjallë, 135 të lindur të vdekur (Tab.1).

Lindje të gjalla sipas gjinisë ishin: Femra 10,567 (48.2%), meshkuj 11,340 (51.58%) dhe koeficienti i maskulinitetit në lindje 1,106.9%.

Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 2,767 (12.6%) komunën e Prizrenit me 1,963 (9.0%) dhe komunën e Ferizajit me 1,463 (6.7%). Komunat me numrin më të vogël të lindjeve ishin komuna e Junikut me 31 (0.1%) dhe komuna e Ranillugës me 19 (0.1%). (Graf.1)




Graf.1. Struktura e lindjeve sipas komunave, 2020

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2020

Trendi i natalitetit


Gjatë vitit 2000, lindshmëria për 1,000 banorë apo nataliteti ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2020 ishte 11.9 %. Lindshmëria për periudhën 2000-2020 ka trend të rënies me lëvizje variabile gjatë viteve. (Graf.4)



Graf.2. Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2019

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2020

Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në Klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 24.1 lindje, pason Prizreni me 8.3 lindje, Gjakova me 4.8 lindje dhe më së paku lindje në Vushtrri me 1 lindje në ditë (Graf. 3).



Graf.3. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020

Të porsalindurit sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe në ishte grup pesha 2500-3999g me 86.53 % dhe grup pesha 4000+g me 8.81%. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.44%. (Tab.4)

Tab.4. Numri i foshnjeve të lindura gjallë sipas peshës trupore në Institucionet Publike dhe private, në vitin 2020

Institucion i	Komuna / Institucion i	Pesha trupore					Gjithsej	Pesha mesatar e
		Nën 1000	1000-1499	1500-2499	2500-3999	4000+		
TOTALI	N	93	140	747	18,160	1848	20,988	3291.2
	%	0.44	0.67	3.56	86.53	8.81	100.00	

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2020

Sipas grup-moshës të nënës, 7,749 (35.5%) të lindur gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet, pasojnë nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 5,819 (26.7%). Mosha mesatare e nënave ka qenë mosha 29 vjeçe. (Tab.5)

Tab.5. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2020

14 e më pak	Grup mosha e nënës									Mosha mesatare
	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë	E pa njohur	
4	610	4,063	7,749	5,819	2,871	593	61	15	13	29
0.0	2.8	18.6	35.5	26.7	13.2	2.7	0.3	0.1	0.1	

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2020

Në vitin 2020 sipas të dhënave të ASK-së nga gjithsej 21,907 të lindur gjallë, 21,341 prej tyre kishin lindur nga një foshnje, 566 kanë lindur binjak dhe nuk janë raportuar asnjë trenjak. (Tab. 6)

Tab.6.Foshnje të lindura sipas numrit

Fëmijë të lindur gjallë	Një	21,341	97.4
	Binjak	566	2.6
	Trenjak	0	0.0
	Gjithsej	21,907	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2020

Sipas gjinisë të të porsalindurve gjallë 10,567 apo (48.2%) janë të gjinisë femërore dhe 11,340 apo (51.8%) të gjinisë mashkullore.

Sipas vendit ku ka lindur fëmija, 21,900 (99.97%) kanë lindur me ndihmë profesionale dhe vetëm 9 të fëmijëve në vend tjetër (Tab. 7)


Tab.7. Të lindur gjallë sipas gjinisë dhe vendit ku ka lindur fëmija, 2020

		Gjinia		Vendi ku ka lindur fëmija	
		Femra	Meshkuj	Në maternitet apo spital	Në vend tjetër
Të lindur gjallë					
N	21,907	10,567	11,340	21,900	9
%	100.0	48.2	51.8	100.0	0.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2020

Në institucionet shëndetësore nga gjithsej **20,781** lindje të raportuara, 4,325 prej tyre apo (20.8%) lindje janë me prerje Cezariene. Në institucionet publike, 3,921 lindje apo (19.3%)

janë me prerje Cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 514 lindje 404 apo (78.6%) janë me prerje Cezariane. (Tab.8, Graf.4)



Graf. 4. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes

Burimi: IKSHPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020

Në klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,639 apo (18.7%) e lindjeve janë me prerje Cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje Cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 653 (38.5%), pason spitali i Gjakovës me 594 (34.0%) dhe spitalet me më pakë raste të raportuara të lindjeve me prerje Cezariane janë Spitali i Vushtrrisë me 101 (36.7%) dhe spitali i Prizrenit me 35 (1.2%), (Tab.8).


Spitalet private nga gjithsej 514 lindje të raportuara 404 apo (78.6%) prej tyre me prerje Cezariane Nëse krahasojmë me 4 vitet paraprake, ka rënie të lindjeve me prerje cezariane.

Përqindja e lindjeve me prerje cezariane për periudhën 2000-2020, ka pësuar rritje përgjatë viteve, sidomos në vitin 2016 me përqindjen më të lartë (26.9%), (graf.6).

Tab.8. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2020


Institucioni		Komuna	Lindje me prerje cezariane		Gjithsej Lindje
			N	%	N
Institucionet Publike	QKUK	Prishtinë	1639	18.7	8786
	Spitali i përgjithshëm	Ferizaj	238	15.5	1534
	Spitali i përgjithshëm	Gjakove	594	34.0	1748
	Spitali i përgjithshëm	Gjilan	402	28.7	1399
	Spitali i përgjithshëm	Mitrovicë	259	16.2	1601
	Spitali i përgjithshëm	Pejë	653	38.5	1694
	Spitali i përgjithshëm	Prizren	35	1.2	3021
	Spitali i përgjithshëm	Vushtrri	101	36.7	275
	Maternitet jashtëspitalore		0	0.0	0
Gjithsej në Institucione Publike			3,921	19.3	20,267
Institucionet Private	Bahceci Healthcare	Prishtinë	0	0.0	0
	Spitali Amerikan, Kosovë	Prishtinë	240	87.0	276
	Spitali Sirona	Prishtinë	86	74.8	115
	"European Clini" Spital privat gjinekologjik/obstetrik	Gjakovë	78	63.4	123
	"FATI IM" Spital privat gjinekologjik/obstetrik	Gjakovë	0	0.0	0
Gjithsej në Institucionet Private			404	78.6	514
Gjithsej			4,325	20.8	20,781

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2020



Graf. 5. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes në dhe llojit të institucioneve shëndetësore

Burimi: IKSHPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2020



Graf.6. Struktura e lindjeve me prerje cezariane për vitet, 2000-2020

Burimi: IKSHPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës

VDEKSHMËRIA E FOSH NJEVE

Mortaliteti infantil është një nga indikatorët e ndikimit (impaktit) sepse reflekton sistemin shëndetësor, kujdesin ante, gjatë dhe pasnatal, kulturën shëndetësore dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të vendit.

Ky indikator paraqet numrin e foshnjave të vdekura prej 0-364 ditë për 1000 lindje të gjalla për një vit.


Gjatë vitit 2020, institucionet shëndetësore publike dhe private kanë raportuar gjithsej 65 foshnje të vdekura.

Prej gjithsej 65 foshnjeve të vdekura, 41 (63.1%) janë (foshnje të vdekura 0-6 ditë), 12 (18.5%) janë (foshnje të vdekura 7-27 ditë) dhe 12 (18.5%) janë (foshnje të vdekura 1-11 muaj) (Tab.9, Graf 6).

Tab. 9. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Foshnje të vdekura	Deri në 24 orë	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
N	24	17	12	12	65
%	36.9	26.2	18.5	18.5	100.0
%	36.9	26.2	18.5	18.5	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020




Graf.6. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

Në vitin 2020 sipas të dhënave të ASK-së, mortaliteti infantil është 3.0‰.


Mortaliteti infantil për periudhën 2011-2020 tregon rënje me lëvizje variabile me mesatare 0.3‰.(Graf.7)



Graf.7. Mortaliteti infantil, 2011-2020

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

Shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 1.9‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.5 ‰ dhe mortaliteti postneonatal 0.5‰. (Graf. 8).



Graf.8. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

Në vitin 2020 nga gjithsej 65 foshnje të vdekura, 36 apo 55.4% foshnje të vdekura janë meshkuj dhe 29 apo 48.7% femra.

Vdekshmëria e foshnjeve sipas gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijës nuk ka dallim sinjifikant me besueshmëri 95%. (Tab.10).

Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor të nënës nga gjithsej 65 foshnje të vdekura 40 apo (61.5%) të nënave e martuar dhe 23 apo (35.4%) të nënave e pa martuar. (Tab.11).

Tab.10. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës, gjinisë,moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmiut

Modalitete		Gjithsej		Moshë e foshnjeve të vdekura		
				Neonata e hershme	Neonatale	Post neonatale
		N				
		N	65	41	12	12
		%	100.0	63.1	18.5	18.5
1	Gjinia	Meshkuj	36	23	6	7
		Femra	25	18	6	5
		$X^2=0.1915 \quad P<0.05$				
2	Moshë e nënës	15 – 24	16	10	2	4
		25 – 34	36	22	8	6
		35+	13	9	2	2
		$X^2=1.2514 \quad P<0.05$				

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

Tab.11. Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor

Statusi martesor i nënës		Moshë e foshnjeve të vdekurve				
		Gjithsej	%	0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë
Statusi martesor i nënës	E pamartuar	23	35.4	15	3	5
	E martuar	40	61.5	25	9	6
	E shkurorëzuar	2	3.1	1	0	1
	Gjithsej	65	100.0	41	12	12

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

VDEKSHMËRIA FETALE

Në vitin 2020 sipas IKSHPK, departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), numri i foshnjeve të lindura pa jetë ka qenë 135, me vdekshmëri fetale prej 6.4%.


Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 99 vdekje fetale (73.3%) kanë ndodhë në QKUK, 30 (22.2%) në spitale, në maternitete jashtëspitalore 2 (1.5%) dhe institucione private 4 (3.0%); (Tab.12).

Tab.12. Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2020

Nr	Institucioni	Prej tyre të lindur pa jetë	
		N	%
1	QKUK	99	73.3
2	Spitalet e përgjithshme	30	22.2
3	Maternitetet jashtëspitalore	2	1.5
4	Institucionet publike	131	97.0
5	Institucionet private	4	3.0
6	Gjithsej	135	100.0

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2020


Sipas IKSHPK-së, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta me 11.1%. Sa i përket spitaleve rajonale, spitalet me shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale janë: Spitali i Prizrenit me 5.6% dhe Gjakovës me 3.4%. Spitali i Ferizajit dhe Vushtrrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 2 vdekje fetale, kurse në institucionet private janë regjistruar 4 vdekje fetale. (Graf.9)



Graf. 9. Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2020

Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2020 ka trend të rënies me lëvizje variabile mesatare prej 0.8%. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2020 është 6.84%. (Graf.10)



Graf.10. Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2020


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar.

Në vitin 2020 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 8.0‰.

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2020 me vlerë mesatare në vit prej 12‰, me tendencë shumë të lehtë të rënies me mesatare me 0.2‰, me lëvizje variable. (Graf.11)



Graf. 11. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2020

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (‰) sipas moshë për vitin 2020:

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale (0 – 6 ditë) është 1.9‰.

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së vonshme neonatale (7 – 27 ditë) është 0.5‰.

Vdekshmëria neonatale (0-28 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (0-28 ditë) është 2.5‰.

Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë)

Vdekshmëria postneonatale është 0.5‰.

Tab.13.Nataliteti, mortaliteti infantil, shtimi natyror sipas komunave, 2020

Komuna	Nataliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	8.0	0.0	2.0
Gjakovë	9.9	1.1	0.5
Gillogoc	13.3	1.2	8.1
Gjilan	12.8	3.0	1.5
Dragash	8.0	0.0	-5.5
Istog	9.8	2.5	2.0
Kaçanik	12.5	0.0	6.6
Klinë	11.6	2.1	3.6
Fushë Kosovë	15.8	0.0	8.3
Kamenicë	9.9	0.0	-2.0
Mitrovicë Jugore	13.8	0.0	4.4
Mitrovicë Veriore	7.0	0.0	-5.2
Leposaviq	3.3	1.3	-4.1
Lipjan	13.7	0.0	6.0
Novobërdë	13.4	2.6	-1.7
Obiliq	21.2	0.0	10.7
Rahovec	11.1	1.1	2.9
Pejë	9.1	0.0	1.5
Podujevë	13.1	18.8	6.9
Prishtinë	12.6	0.5	5.5
Prizren	10.1	0.0	2.3
Skënderaj	12.3	0.0	5.7
Shtime	13.6	0.0	7.4
Shtërpcë	16.8	3.0	-9.2
Suharekë	11.5	0.0	3.7
Ferizaj	13.8	0.0	6.6
Viti	10.2	0.0	3.5
Vushtrri	16.4	0.0	7.1
Zubin Potok	8.3	0.0	1.5
Zveçan	5.9	0.0	-6.7
Malishevë	13.8	0.0	9.1
Junik	4.9	0.0	-2.0
Mamushë	13.3	0.0	3.1
Hani i Elezit	12.9	0.0	5.7
Graçanicë	13.2	0.0	-2.5
Ranillug	5.1	0.0	-19.0
Partesh	13.5	0.0	-21.8
Klllokot	12.9	0.0	2.2
Gjithsej	11.9	3.0	3.9

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve, 2020

PËRFUNDIMET

- Në vitin 2020, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 21,907 foshnje të lindur gjallë, prej tyre 479 jashtë Kosovës.
- Prej gjithsej lindjeve në Kosovë, të lindur gjallë janë 21,907 dhe 135 të lindur vdekur.
- Sipas gjinisë së të porsalindurve, të gjinisë mashkullore janë 11,452 (52.5%), femra 10,346 (47.5%), me raportin gjinor në lindje prej 1,106 meshkuj në çdo 1,000 femra të lindura gjallë.
- Në institucionet shëndetësore në vitin 2020 nga gjithsej lindje 21% të lindjeve janë kryer me prerje cezariene
- Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 11,272 apo 54.2%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 8,786 lindje apo 42.3%, në maternitete 209 lindje apo 1.3%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 514 lindje ose 2.5%.
- Lindje të gjalla sipas gjinisë ishin: Femra 10,567 (48.2%), meshkuj 11,340 (51.58%) dhe koeficienti i maskulinitetit në lindje 1,106.9%.
- Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë janë raportuar në komunën e Prishtinës me 2,767 (12.6%), komunën e Prizrenit me 1,963 (9.0%) dhe komunën e Ferizajt me 1,463 (6.7%). Komunitet me numrin më të vogël të lindjeve ishin komuna e Junikut me 31 (0.1%) dhe komuna e Ranillugës me 19 (0.1%).
- Lindshmëria për periudhën 2000-2020 ka trend të rënies me lëvizje variabile.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së me 24.1 lindje, pason Prizreni me 8.3 lindje, Gjakova me 4.8 lindje dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë.
- Me grup-peshë < 2500g janë 1,121 apo 5.1% të foshnjave të porsalindura.
- Mosha mesatare e nënave është mosha 29 vjeçare.
- Në institucionet shëndetësore nga gjithsej 20,781 lindje të raportuara, 4,325 prej tyre apo (20.8%) lindje janë me prerje Cezariene. Në institucionet publike, 3,921 lindje apo (19.3%) janë me prerje Cezariene ndërsa në institucionet private nga gjithsej 514 lindje 404 apo (78.6%) janë me prerje Cezariene.
- Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje Cezariene është realizuar në spitalin e Pejës 653 (38.5%), pason spitali i Gjakovës me 594 (34.0%) dhe spitalet me më pakë raste të raportuara të lindjeve me prerje Cezariene janë Spitali i Vushtrrisë me 101 (36.7%) dhe spitali i Prizrenit me 35 (1.2%).
- Të porsalindurit sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe në ishin grup pesha 2500-3999g me 86.53 % dhe grup pesha 4000+g me 8.81%. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.44%.

- Prej gjithsej 65 foshnjave të vdekura, 41 (63.1%) janë vdekje neonatale të hershme (0-6 ditë), 12 (18.5%) janë vdekje neonatale e vonshme (7-27 ditë) dhe 12 (18.5%) janë vdekje postneonatale (1-11 muaj).
- Shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 1.9‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.5 ‰ dhe mortaliteti postneonatal 0.5‰.
- Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2020 është 3.0‰.
- Mortaliteti infantil për periudhën 2011-2020 tregon rënje me lëvizje variabile me mesatare 0.3‰.
- Mortaliteti infantil sipas komunave, më i larti është në komunën e Prishtinës me 18.8‰ dhe komunat e Gjilanit e Suharekës me 3.0‰.
- Nga gjithsej 65 foshnje të vdekura, 36 (55.4%) janë të gjinisë mashkullore dhe 29 (44.6%) të gjinisë femërore, pa dallim sinjifikant sipas gjinisë dhe moshës së nënës.
- Numri i foshnjave të lindura vdekur për vitin 2020 sipas departamentit të SISH-it është 135, me vdekshmëri fetale prej 6.4‰.
- Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor nga gjithsej 135 vdekje fetale 92 apo (63.4%) kanë ndodhë në QKUK, 48 (27.9%) në spitale dhe në maternitete jashtë-spitalore 1apo (0.7%).
- Shkalla e vdekshmërisë fetale më e larta ishte në nivelin terciar në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike me 11.1‰. Spitalet me shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale janë: Spitali i Prizrenit me 5.6‰ dhe Gjakovës me 3.4‰. Spitali i Ferizajt dhe Vushtrrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale.
- Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2020 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.8‰.
- Në vitin 2020 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 8.0‰.
- Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2020 tregon tendencë shumë të lehtë të rënies mesatare me 0.2‰, mirëpo me lëvizje variabile.

REKOMANDIMET

- Urgjentisht në grumbullim raportim të të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Të zbatohet në praktikë pyetësi i unifikuar për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante.
- Të sigurohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjave.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të fuqizohet qasja multidisciplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokollet klinike relevante dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të planifikohet konform të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Të zgjerohet programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë në të gjitha komunat.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të përforcohet koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të autoriteteve qeveritare shëndetësore qendrore dhe atyre lokale, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, asociacioneve të tjera profesionale dhe shoqërisë civile.

- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.
- Të përkrahet edukimi shëndetësor për shtatzënat, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes

BIBLIOGRAFIA

- 1. IKSHPK, Raporti i lindjeve në institucionet shëndetësore për vitin 2020 Lindjet 2020**
- 2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2020**
- 3. ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2020**
- 4. Raporti Perinal European, 2015**

ANEKS

Të dhënat demografike, 2020-Kosovë

Komuna	Banorë	Lindur gjallë	Vdekur	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	42,480	339	252	8.0	5.9	0.0	2.0
Gjakovë	94,334	936	887	9.9	9.4	1.1	0.5
Glogoc	61,145	815	318	13.3	5.2	1.2	8.1
Gjilan	77,145	991	875	12.8	11.3	3.0	1.5
Dragash	33,948	271	457	8.0	13.5	0.0	-5.5
Istog	41,181	403	320	9.8	7.8	2.5	2.0
Kaçanik	34,672	433	205	12.5	5.9	0.0	6.6
Klinë	40,489	468	322	11.6	8.0	2.1	3.6
Fushë Kosovë	39,948	633	302	15.8	7.6	0.0	8.3
Kamenicë	27,948	278	334	9.9	12.0	0.0	-2.0
Mitrovicë Jugore	69,331	957	652	13.8	9.4	0.0	4.4
Mitrovicë Veriore	11,994	84	146	7.0	12.2	0.0	-5.2
Leposaviq	13,202	44	98	3.3	7.4	0.0	-4.1
Lipjan	57,928	794	444	13.7	7.7	1.3	6.0
Novobërdë	7,158	96	108	13.4	15.1	0.0	-1.7
Obiliq	18,218	386	191	21.2	10.5	2.6	10.7
Rahovec	57,047	633	468	11.1	8.2	0.0	2.9
Pejë	98,601	899	754	9.1	7.6	1.1	1.5
Podujevë	82,023	1,078	512	13.1	6.2	0.0	6.9
Prishtinë	218,782	2,767	1,553	12.6	7.1	18.8	5.5
Prizren	194,581	1,963	1,510	10.1	7.8	0.5	2.3
Skënderaj	52,714	646	347	12.3	6.6	0.0	5.7
Shtime	27,450	374	170	13.6	6.2	0.0	7.4
Shtërpcë	6,621	111	172	16.8	26.0	0.0	-9.2
Suharekë	58,194	672	454	11.5	7.8	3.0	3.7
Ferizaj	106,286	1,469	772	13.8	7.3	0.0	6.6
Viti	47,896	490	321	10.2	6.7	0.0	3.5
Vushtrri	62,926	1,030	583	16.4	9.3	0.0	7.1
Zubin Potok	6,664	55	45	8.3	6.8	0.0	1.5
Zveçan	7,290	43	92	5.9	12.6	0.0	-6.7
Malishevë	57,261	792	271	13.8	4.7	0.0	9.1
Junik	6,383	31	44	4.9	6.9	0.0	-2.0
Mamushë	5,874	78	60	13.3	10.2	0.0	3.1
Hani i Elezit	10,090	130	72	12.9	7.1	0.0	5.7
Graçanicë	12,229	162	192	13.2	15.7	0.0	-2.5
Ranillug	3,737	19	90	5.1	24.1	0.0	-19.0
Partesh	1,699	23	60	13.5	35.3	0.0	-21.8
Kllokot	2,719	35	29	12.9	10.7	0.0	2.2
Gjithsej	1,798,188	21,428	14,482	11.9	8.1	3.0	3.9

Burimi : ASK, Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2020